

SHMANGIA E PROBLEMEVE ME PRETENDIMIN TUAJ PËR SIGURIMIN E PAPUNËSISË

Si të siguroheni në kohë dhe të saktë
Pagesat e përfitimit të sigurimit të papunësisë (UI).

JINI TË SINGQERTË

Mbajtja e qëllimshme ose dhënia e informacioneve mashtruese, të pasakta mbi një pretendim për përfitimet e sigurimit të papunësisë konsiderohet mashtrim, i cili dënohet sipas ligjit. Sigurohuni që të kontrolloni dy herë të gjitha informacionet që jepni nëse janë të sakta, kur paraqisni një kërkesë për përfitimet e sigurimit të papunësisë.

✓ REGJISTROHUNI SI PUNËKËRKUES

Ju duhet të paraqisni një aplikim në Departamentin e Punës të Shtetit të Nju Jorkut (NYSDOL) për përfitimet e sigurimit të papunësisë. Mënyra më e lehtë për të aplikuar është në internet në unemployment.labor.ny.gov. Çdo pretendim është unik dhe duhet të vlerësohet nga NYSDOL për të përcaktuar përshtatshmërinë. Gjatë kësaj kohe, NYSDOL do të ofrojë shërbime të kërkimit të punës që janë krijuar për t'ju ndihmuar të ktheheni në punë sa më shpejt të jetë e mundur.

✓ KËRQONI NË MËNYRË AKTIVE PËR PUNË

Ju duhet të kryeni të paktën tre aktivitete të kërkimit të punës për çdo javë që paraqisni një kërkesë për përfitime. Sigurohuni që të mbani një regjistër të aktiviteteve tuaja të kërkimit të punës, pasi pretendimi juaj mund të zgjidhet për një auditim në çdo kohë.

✓ MOS REFUZONI PUNËN E PËRSHTATSHME

Refuzimi i një oferte të përshtatshme pune mund të rezultojë në një mohim ose vonesë të pagesave të përfitimeve tuaja.

Vizitoni faqen tonë të internetit në dol.ny.gov/unemployment nëse keni pyetje shtesë në lidhje me kërkesën tuaj.

✓ RAPORTONI TË GJITHË PUNËN

Ju duhet të raportoni të gjitha orët e punës për çdo javë që punoni kur aplikoni për përfitime të sigurimit të papunësisë, duke përfshirë punën me kohë të pjesshme ose të përkohshme.

✓ LEXONI INFORMACIONIN E DHËNË

Ju jeni përgjegjës për njohjen dhe ndjekjen e rregullave të sigurimit të papunësisë të Nju Jorkut kur aplikoni për përfitimet e sigurimit të papunësisë. Për të parandaluar gabimet që mund të rezultojnë në një mbipagesë, duhet të lexoni me kujdes të gjitha materialet që ju dërgohen dhe t'u përgjigjeni kërkesave.



Shikoni udhëzuesin e procesit të përfitimit të pretenduesit të sigurimit të papunësisë